



Planuar / Doretuar Planned / Ordered	22.03	2023	3	viti god year
Priljevoj / Prodato Received / Delivered				
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sania Kolicina Quantity	
SKMB/HUK	2893/2023		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.252/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi- anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.252/2023 të datës 27.01.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në punë të datës 10.01.2023 të Udhëheqësit të Divizionit për Armë, Municione dhe Eksploziv të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.252/2023 e datës 27.01.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për vitin 2022 i datës 10.01.2023, për ankuesin.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 22.08.2013 në pozitën *Zyrtar i lartë për shënjim, gjurmim, deaktivizim dhe shkatërrim në Departamentin e Sigurisë Publike /Ministria e Punëve të Brendshme*, më datë 27.01.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1022/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022 të datës 10.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.02.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli, me datë 07.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1022/2023 e datës 27.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për 23.07.2022 për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës 10.01.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 15.11.2015;

Vendim i datës 10.02.2022 me nr.219/2022; Vendim i datës 28.07.2022 me nr.1187; Vendim i datës 27.10.2022 me nr.0721; Vendim i datës 28.11.2022 me nr.1774/2022; Vendim i datës 04.04.2022 me nr.527/2022; E-mail zyrtar i datës 28.11.2022 –Raporti i vlerësimit afatëmesëm 2018 -2022 të udhërrefyesit për AVL; E-mail Zyrtar i datës 05.01.2023-Raporti i dhjetorit 2022 dhe i tërë vitit 2022; E-mail zuyrtar i datës 28.1s 0.2022; E-mail zyrtar i datës 24.10.2022; E-mail Zyrtar i datë 20.10.2022; E-mail zyrtar i datës 18.10.2022; E-mail zyrtar i datës 17.10.2022; E-mail zyrtar i datës 17.10.2022; E-mail zyrtar i datës15.09.2022-kërkesë; E-mail zyrtar i datës 12.09.2022; E-mail zyrtar i datës 23.08.2022; E-mail zyrtar i datës 27.07.2022; E-mail zyrtar i datës 26.07.2022; E-mail zyrtar i datës 20.06.2022; E-mail zyrtar i datës 17.06.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.02.2023 me numër protokolli 1408/2022; Përgjigje në ankesë e datës 07.03.2023 nga organi i punësimit me numër protokolli 2430/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 22.08.2013; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 21.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 03.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 10.01.2023; Përgjigje e datës 26.02.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 dhe Plani vjetor i Departamentit për Siguri Publike për vitin 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pa bazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022 të datës 10.01.2023, pretendon që vlerësimi është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punës dhe dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe provave të lëndës, konstaton se sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, Ulët dhe Profesional për vitin 2022, ankuesi është vlerësuar me notë të përgjithshme 2.87 që nënkupton mirë.

Referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 43 paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar që: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit”,* ndërsa neni 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike përcakton se: *“Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar)”*, rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në kuadër të objektivave të përcaktuar.

Duke u bazuar në provat e lëndës si dhe formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, del se ankuesi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.87, që nënkupton se ka arritur të gjitha objektivat në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota*

nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë";, ndërsa në kuadër të kuptimit të notave sipas paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të këtij neni, përcaktohet që: "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës", bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4, 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, nenin 8, nenin 10, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, sepse meqë ankuesi është vlerësuar me mirë, rrjedhimisht sipas Kolegjit të Këshillit të njëjtit nuk i janë cenuar të drejtat për ngritje profesionale dhe ngritje në karrierë në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.252/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsorë GASHI-BAJRAKTARI

Malsorë Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

